



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.65

Prishtinë, më 26.10.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu, Shpejtim Bulliqi dhe Mufera Shinik.

Munguan: Sergjan Popoviq dhe Shukrije Bytyqi.

Përfaqësues të ftuar: Kujtim Shala, Ministër i MKRS

Përfaqësues të tjerë: Mediat, nga OSBE dhe KDI.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi, Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të datës 10.10.2016;
3. Raportimi i Ministrit të Kulturës lidhur me gjendjen në infrastrukturën sportive dhe trashëgiminë kulturore;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të datës 10.10.2016

procesverbali i mbledhjes së mbajtur më datë 10.10.2016 u miratua pa vërejtje.

3. Raportimi i Ministrit të Kulturës lidhur me gjendjen në infrastrukturën sportive dhe trashëgiminë kulturore

Nait Hasani tha se kemi pranuar një raport nga përfaqësuesja e OKB, mbi çështjen e trashëgimisë të cilën e vlerësuan si të rëndë, dhe jo tolerante. Si komision objektet që kemi vizituar, kemi parë gjendje të rëndë në to dhe në raportin e Këshillit për Trashëgimi, paraqitet gjendja e rëndë e objekteve të trashëgimisë kulturore.

Sa i përket zhvillimit të ndeshjeve ndërkombëtare të kombëtares, FFK-ja ka vendosur që të luaj jashtë Kosovës, dhe Komisioni për mbikëqyrjen e sportit është anashkaluar. Infrastruktura në fushat e sportit është mjaftë e rëndë dhe ato nuk i plotësojnë as kushtet minimale për zhvillimin e ndeshjeve ndërkombëtare. Buxhetet e ndara nga komunat për rregullimin e fushave, janë minimale dhe nuk mjaftojnë. Kërkojmë nga ju një pasqyrë të qartë të aktiviteteve tuaja për fushën e Trashëgimisë dhe sportit.

Ministri Kujtim Shala tha se Ministria për fushën e trashëgimisë kulturore ka për bazë dy dokumente themelore që janë Lista për mbrojtje të përkohshme me 1534 asete dhe Lista për mbrojtjen e përhershme të aseteve me 23 asete. Ai tha se janë disa projekte të rëndësishme siç janë: Kalaja e Novobërdës, Kalaja e Prizrenit, Harilaqit etj.

Sipas tij, deri më tani nuk ka pasur plane strategjike dhe se buxheti gjatë dy viteve të fundit për trashëgimi është rritur për 20% më shumë. Ministri më tej theksoj se mbrojtja e trashëgimisë është punë e përditshme, tha se janë arritur marrëveshje për një plan trajnimi për fushat specifike me Maltën, Kroacinë dhe disa vende tjera të Ballkanit, pasi që ka deficit të kuadrove për këtë fushë.

Ministri ngriti problematikën e aseteve të veçanta sidomos kur ato janë prona private të cilat sipas tij po i pamundësojnë intervenimet e nevojshme në objektet që rrezikohen të dëmtohen edhe më tej, si dhe problemet me karakter politik janë një tjetër pengesë e theksuar për MKRS.

Nait Hasani, parashtroi para përfaqësuesve të MKRS, çështjen e Qendrës historike të Prizrenit, për të cilën tha që është e rëndë dhe afërsisht 10 objekte rrezikohen nga shembja.

Ministri, tha se MKRS ka kontratë për rivitalizimin dhe shmangien e degradimit të mëtejshëm të këtyre objekteve si dhe buxheti për Qendrën historike është i siguruar dhe mendojmë që është i mjaftueshëm për realizimin e punëve të parapara.

Bekim Haxhiu parashtroi pyetjen rreth rishikimit të buxhetit për vitin 2016, duke vënë theksin në atë se çfarë ka bërë Ministria për shtëpitë muze në Lagjen e Jasharajve.

Ministri tha se në Kosovë nuk ka kompani të licencuar për trashëgimi tha se ka vendosur që Institucionit që merret me mbrojtjen e Monumenteve të bashkëpunon me qendrat rajonale, pasi që Agjencioni nuk ka një kompetencë të tillë as ligjore as profesionale.

Ismajl Kurteshi në diskutimin e tij tha se sipas raportit të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, gjendja e trashëgimisë kulturore nuk është aspak e mirë sikurse edhe Trashëgimia arkeologjike. Sa i përket Trashëgimisë së luajtshme tha se është e vështirë të konstatohet gjendja e saj, duke shpresuar që Ministria të themelojë Qendrën Nacionale të Inventarizimit. Në lidhje me trashëgiminë arkitekturale, gjendja vazhdon të jetë ende jo në nivelin e duhur. Objektet e kulteve fetare kanë vazhduar të rrënohen që nga paslufta dhe në vend të tyre janë ndërtuar objekte me karakter krejtësisht të kundërt, edhe pse ato me parë ishin shpallur nën mbrojtjen e shtetit.

Më tej kërkoi sqarim lidhur me përzgjedhjen e punë kryesve të Kalasë së Artanës dhe Prizrenit, çka është ndërmarrë për ruajtjen e Përmendoreve të ndërtuara pas luftës, dhe sa e përcillni ju punën e Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Teuta Haxhiu, foli rreth Zonës historike të Prizrenit duke ngritur çështjen e përgjegjësisë individuale apo institucionale për gjendjen e saj. Një çështje tjetër e paraqitur ishte Task Force e Qeverisë për UNESCO duke pyetur se a janë përfshi të gjitha institucionet e fushës.

Ajo shtoi çështjen e themelimit të disa këshillave drejtues siç është Këshilli drejtues i Muzeut, i Institutit arkeologjik, teatrit etj., dhe cila është baza ligjore e themelimit të tyre, si dhe çështjen rreth rivitalizimin dhe rindërtimit të shtëpisë së Xhafer Davës në Mitrovicë.

Mufera Shinik pyeti rreth ruajtjes së origjinalitetit të monumenteve gjatë restaurimit. Ajo ngriti edhe çështjen e Xhamisë në Kalanë e Prizrenit si dhe leja dhe buxheti për të. Problematika me lejen e shtëpive të trashëgimisë kulturore dhe atyre të vjetra në të cilën banojnë shumë familje ishte një tjetër shqetësim i ngritur nga ajo.

Salih Morina tha se Ligji për Hoqën e madhe dhe atë të Prizrenit janë hartuar me asistencë ndërkombëtare por që ka probleme në zbatim. Ai pyeti se a do të rikthehet ky ligj në Kuvend dhe sa do të jetë buxheti për trashëgiminë për vitin e ardhshëm.

Shpejtim Bulliqi shtoi pyetje për Hamamin e Prishtinës, çka është ndërmarrë për kthimin e gjendjes së objektit në gjendjen e duhur, si dhe veprimet konkrete për tejkalimin e vështirësive/problemeve në anëtarësimin në UNESCO.

Nait Hasani theksoi se në vizitën e realizuar në Bibliotekë, u njoftuan nga drejtuesit e Bibliotekës se në pjesën e arkivit pikonte uji dhe që rrezikonte dëmtimin e librave dhe se në këtë mënyrë rrezikohej dëmtimi jo vetëm i objektit por tërë pasurisë intelektuale që mund ta ketë Kosova. Cilat janë mundësitë buxhetore që të intervenohet sa më parë që gjendja të mos përkeqësohet.

Ministri iu përgjigj pyetjeve të parashtruara duke thënë se në Kalanë e Prizrenit, dëmtimet e murit kanë ndodhur për shkak të rrëshqitjes. Sa i përket Kalasë së Novobërdës, ai është projekt i përbashkët i MKRS-së, Këshillit të Evropës dhe UNESCO. Buxheti është i Këshillit të Evropës ndërsa sa i përket Procedurave për Përzgjedhjen e kompanive bëhet sipas standardeve të UNESCO dhe sipas memorandumit me MKRS. Në pyetjen për përmendoret ai tha se përgjegjës është Agjencinë i Memorialëve. MKRS ka përgjegjësi për disa përmendore të cilat janë në listën e përkohshme për mbrojtje. Sipas Ministrit nuk ka lokalitet arkeologjik që nuk është në përkujdesje por karakteri i intervenimeve dhe mbrojtjes dallojnë sipas nevojës; me karakter studimi, shpëtimit, restaurimi dhe konservimi.

Sa i përket shtëpisë muze së Xhafer Davës, tha se është djegur dy here dhe për të kujdeset qendra rajonale e trashëgimisë në Mitrovicë, është dashur të bëhet një projekt i ri për shtëpinë dhe është kontraktuar pune kryesi. Task force e Qeverisë, nuk ka të bëjë me UNESCO, është task force që merret me organizata që janë shumë më të vogla, siç ndodhi pak ditë më parë kur Biblioteka kombëtare u bë anëtare e IFLA. Kjo task force ka për detyrë të mbledh informacione dhe të sugjerojë për aplikime dhe aderime në organizata tjera.

Ministri tha se sipas raportit të task forces për Prizrenin, ai ka shpërputhje dhe mosrespektim të normave. Xhamia brenda kalasë është lokacion arkeologjik dhe duhet të kemi kujdes që kur ndërtojmë të ruajmë shtresat origjinale. Sa i përket lejeve për shtëpitë, ne japim lejet, sivjet janë dhënë diku rreth 200 leje.

Ministri në pyetjen rreth Ligjit për Trashëgiminë, tha se kemi pasur problem të natyrës politike. Është pjese e pakos legislative për këtë vit por nuk beson që do të finalizohet. Kërkohej pajtim mes palëve dhe sipas Kushtetutës konsiderohet me interes vital dhe duhet të miratohet me 2/3 e dyfishta.

Sa i përket punimeve në hamamin e Prishtinës, kemi dy çështje që lidhen me trashëgiminë. Nuk është çështje e mungesës së vullnetit dhe buxhetit, por Komuna e Prishtinës dyshon që mund të ketë keqpërdorime dhe ka proceduar lëndën në prokurori dhe konsiderojnë që nëse ne ndërhyjmë me punime do të mund të dëmtojmë provat e mundshme.

Lidhur me problemin në Bibliotekë tha se është duke u bërë një studim dhe në bazë të tij do të do të intervenohet dhe në këtë mënyrë të evitohet rrezikimi i dorëshkrime që janë të rralla dhe të vjetra mbi 800 vjet.

Teuta Haxhiu shtroi çështjen e stadiumit Agron Rama në Obiliq duke pyetur se çka është bërë që të jetësohet kërkesa e komunës.

Bekim Haxhiu foli për kushtet e përgjithshme në terrenet sportive të cilën e vlerësojë si jo të sigurt dhe shprehi nevojën që këto çështje të rregullohen me ligj dhe në këtë mënyrë të evitohen rreziqet e ndonjë tragjedie apo fatkeqësie eventuale. Dy vitet e fundit kemi pasur diskutime të shpeshta, me theks të veçantë për futboll. Ngecjet në renovime në stadiumin e Mitrovicës ku përfshihen reflektorët, tribuna për VIP, ku mjetet e ndara në vitin 2015 për këto qëllime nuk janë shfrytëzuar. Zyrtaret e UEFA në inspektimet e fushave tona sportive, kanë dhënë vërejtjet e tyre dhe ato janë 29 sosh, ku sipas tyre me plotësimin e këtyre 29 vërejtjeve, stadiumi “Adem Jashari” në Mitrovicë do të ishte i gatshëm për ndeshje ndërkombëtare. Po ashtu ka ngecje në renovimet në stadiumin e qytetit të Prishtinës dhe ndërtimin e stadiumit nacional. Sipas eksperteve të infrastrukturës të UEFA dhe FIFA-s, duhen ndryshime dhe plotësime në projektin e renovimit të stadiumit në Prishtinë. A keni kërkuar llogaridhënie nga hartuesit e këtij projekti dhe cilat ishin kriteret e përdorura nga hartuesit e projektit të cilat kritere nuk u pranuan nga ekspertet e UEFA-FIFA-se.

Nait Hasani tha se MKRS ka investuar mbi 300mije euro për renovimin e stadiumit të Lirisë para 3-4 vjetëve. Tash se fundmi, Komuna e Prizrenit ka ndarë 2.8mil euro investim për renovimin e tij.

Ismajl Kurteshi tha se infrastruktura në stadiumet regjionale është mjaft e keqe.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit
 5. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive
Shqyrtimi i dy Projektligjeve mbetet për mbledhjen e radhës.
 6. Të ndryshme
- Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime

Mbledhja përfundoi në orën 11:55.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

**Kryetari i Komisionit
Nait Hasani**